



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E KULTURËS
Sektori për Rini dhe Sport
THIRRJE PËR APLIKIM

Për subvencionim të Klubeve Sportive Publike të cilat do të zhvillojnë aktivitetet sportive sipas plan programit të tyre për fazën e dytë për vitin 2017.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha Klubet /Shoqatat sportive publike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Prishtinës që tashmë janë dëshmuar me përgjegjshmëri dhe qëndrueshmëri në zhvillimin dhe masivizimin e sportit ndër të rinj, gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Sektorit për Rini dhe Sport, konkretisht në fushën e Sportit.

Kërkesa duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit,
- Përshkrimin e aktiviteteve të projektit / plan programit të sezonit pranveror bashkë me koston e tyre,
- Kostoja që kërkohet nga Komuna,
- Rezultatet e arritura në vitin paraprak

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-ës;
- Certifikata e numrit fiskal të klubit/shoqatës;
- Letërnjoftimi i bartësit të xhirollogarisë;
- Vërtetimi / dëshmia e bankës në emër të subjektit i cili aplikon (klubit/shoqatës/individit)
- Të dhënat e aplikuesit: telefoni , email adresa.

Data e aplikimit është nga **21.07.2017 deri 01.08.2017**. Aplikimi bëhet në objektin e vjetër të Komunës, Zyra pritëse (sporteli nr. 5) Adresa Rr. UÇK Nr.2 Prishtinë.

Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të detajuara me lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Prishtinës.

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në vegzën: <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Subvencionet/Subvencione-per-Rini-dhe-Sport/Formularet-per-aplikim.aspx>

Vërejtje:

Nuk do të merren në shqyrtim:

- **Klubet/Shoqatat të cilët nuk kanë përmbyllur projektin dhe nuk kanë raportuar për kontratën paraprake,**
- **Klubet/Shoqatat të cilët nuk janë përgjegjgur kërkesës së DK-së për plotësimin e Formularit të sportit komunal 2017.**
- **Konkurruesit të cilët nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar.**
- **Kërkesat e dorëzuara pas afatit, nuk do të merren parasys.**

Nëse keni nevojë për informata shtesë, na kontaktoni.